



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 14.04.2026

Përschendetje,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e vazhdueshëm, në lidhje me rastin e z. P. P, përfitues i pensionit të pleqërisë në DRSSH Lezhë, ju informojmë si vijon:

Sipas Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lezhë, rezulton se kërkuesit i është caktuar pension pleqërie, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi 01.03.2014, me masë fillestare 12,024 lekë në muaj dhe me 36 vite e 9 muaj periudhë sigurimi.

Në llogaritjen e vjetërsisë janë përfshirë periudhat e deklaruara:

- 06.07.1965 – 24.11.1968, N.T.A.SH Laç
- 14.12.1968 – 27.11.1970, shërbimi ushtarak
- 08.01.1971 – 01.06.1974, N.T.A.SH Laç
- 05.06.1974 – 31.12.1992, Ndërmarrja e Spedicionit Laç + Parku i Mallrave Laç
- 01.10.1993 – 31.12.2001, i vetëpunësuar në bujqësi
- 01.11.2011 – 15.02.2014, Arqidioqeza Metropolitane Shkodër-Pult

Në llogaritjen e vjetërsisë janë përfshirë të gjitha periudhat e deklaruara prej kërkuesit.

Llogaritja e masës së pensionit bëhet në zbatim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, ku citohet:

“Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 për qind e pagës neto mesatare të 3 viteve rresht të 10 viteve të fundit të punës të personit të siguruar, cila të jetë më e vogël.”

Në 10-vjeçarin e fundit të punës (15.02.2004 – 28.02.2014), rezulton se është siguruar për periudhën 01.11.2011 – 28.02.2014, në subjektin Arqidioqeza Metropolitane Shkodër-Pult.

Pas llogaritjes, paga mesatare mujore neto për këtë periudhë ka rezultuar 14,625 lekë.

Duke aplikuar 75%, masa e pensionit rezulton 10,969 lekë, por z. P. P. ka përfituar pensionin minimal 12,024 lekë në muaj, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 4, të VKM-së nr. 513, datë 17.07.2013 “Për rritjen e pensioneve”, ku përcaktohet se: **pensionet e plota të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 7703/1993, me datë fillimi nga 01.08.2013 e në vazhdim, nuk mund të jenë më pak se 12,024 lekë në muaj.**

Masa aktuale e pensionit është 18,335 lekë në muaj, ndërsa totali i të ardhurave është 22,285 lekë në muaj.

Në datën 23.02.2026, kërkuesi i është drejtuar DRSSH Lezhë me kërkesë për rishqyrtim të pensionit, me të njëjtin subjekt si në ankesën e bashkëlidhur në këtë korrespondencë, dhe nga kjo e fundit i është kthyer përgjigje në datën 14.04.2026, të cilën z. P mund ta gjej në seksionin “Hapësira ime” → “Dokumentet e mia” në llogarinë tij në e-Albania.

Ju faleminderit për bashkëpunimin !